

Ekskluzive

# Ekskluzive | Të shtëna në aheng familjar në Rahovec – Policia bastis shtëpinë dhe sekuestron armën



Sinjali.com

01 Gusht 2026 10:57



**Një aheng familjar në fshatin Drenoc të Rahovecit është shoqëruar me të shtëna me armë, duke çuar në ndërhyrjen e Policisë dhe sekuestrimin e armës që dyshohet se u përdor gjatë festës.**

Sinjali mëson se i dyshuari është **Shkodran Rexhepi rreth 27-vjeçar**.

Sipas burimeve, rasti ka ndodhur mbrëmjen e 31 korrikut, rreth orës 22:40 pasi Policia u njoftua nga persona anonimë për të shtëna me armë zjarri në një aheng familjar në fshatin Drenoc.

Dy patrulla policore kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes, ku gjatë bastisjes kanë gjetur dhe sekuestruar një pistoletë me gaz të tipit “BRUNI MOD 92”, pa numër serik, kalibër 9 mm, prodhim italian. Gjithashtu janë sekuestruar një karikator me tre fishekë dhe shtatë gëzhoja me gaz, të cilat dyshohet se janë përdorur gjatë incidentit.

Për rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit, i cili ka urdhëruar inicimin e procedurës penale për veprat “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorim i armës”.

Pas intervistimit, Shkodran Rexhepi është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa hetimet për rastin vazhdojnë.

**Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.**

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

***/GazetaSinjali/***

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



## Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

## Aktualitet

Politikë  
Drejtësi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

## Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

## Ekonomi

Prodhime Vendore  
Financa  
Biznes

## Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

## Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

## OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

## Jetë

Fitness  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

## Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

## Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

## Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera